

DRITAN EGRO

**NACIONALIZMI SHQIPTAR SI FENOMEN
HISTORIOGRAFIK**

E shkuara historike gjithmonë ka qenë një pikë e fortë reference prej nga ku janë frymëzuar lëvizjet nacionale. Lavdia e së shkuarës bëhet domosdoshmëri për ndriçimin e historisë nacionale, ndaj dhe momentet më të rëndësishme të saj ndriçohen më fort se të tjerat. Nga ana tjetër, ngjarjet e mëdha të historisë i shërbejnë lëvizjeve nacionaliste si një instrument i fuqishëm për rritjen e ndërgjegjes dhe sigurimin e unitetit kombëtar, madje edhe si një justifikim i argumentuar për realizimin e aspiratave të porealizuara nacionale¹. Është fenomen tipik për historiografitë me moshë të re që të obsesohen me çështje të historisë nacionale, pasi formëzimi i historisë nacionale është një nga të parat *raison d'être*, sidomos në një rajon si Ballkani, i cili sapo kishte dalë nga një sundim i gjatë perandorak.

Duke pasur gjithmonë parasysh faktin që mendimi historik ndikohet fuqishëm nga ideologjia, në rastin e studimeve historike mund të thuhet se historiografia shqiptare për këtë periudhë historike ishte aq e lidhur me zhvillimet politike të brendshme dhe të jashtme, sa edhe vetëm një lexim i vëmendshëm i studimeve të kryera të jep mundësinë e përcaktimit se në cilin segment kohor dhe në çfarë kushtesh politike janë shkruar ato. Për ta ilustruar këtë ide mund të themi se edhe historiografia nacionaliste nuk ka ekzistuar para se të lindë vetëdija kombëtare dhe, më pas, ideologjia nacionaliste. E thënë ndryshe, lëvizjet nacionale sollën me vete edhe historiografinë romantiko-nacionaliste, madje më pas edhe një lidhje të fortë dhe të pandashme në mes tyre. Ishte presioni politik që vinte nga qarqet nacionaliste, faktori që i orientoi intelektualët, njohës të

¹ G. Soulis, "Historical Studies in the Balkans in Modern Times", *The Balkans in Transition: Essays on the Development of Balkan Life and Politics since the 18th century*, edited by Ch. & B. Jelavich, Archon Books 1974, f. 421.

historisë dhe kulturës, që së pari në shkrimet e tyre të trajtonin çështje të historisë kombëtare. Mendimtari turk Peyami Safa thotë: “Të gjithë popujt që spekullojnë me historinë e vet janë të destinuar të rrezikojnë edhe ekzistencën e tyre”².

Kushte të ndryshme historike doemos sjellin një preokupim dhe intensitet të ndryshëm në përjetimin e historisë, në formimin e vetëdijes kombëtare, por edhe në shkrimin e historisë. Qysh në gjysmën e dytë të shekullit XIX historishkrimi i historisë kombëtare ishte disiplina e cila më së shumti i dha formë vetëdijes kombëtare dhe duhet perceptuar si pjesa esenciale e prodhimit politik dhe kulturor shqiptar që formëzoi dhe më pas mbështeti ideologjinë nacionaliste deri në momentet e konsolidimit të shtetit shqiptar.

Gjithsesi, historiani ballkanas asnjëherë në mendjen e tij nuk e ka ndarë aktivitetin shkencor nga pjesëmarrja në zhvillimet politike të vendit të tij. Ky vlerësim është plotësisht legjitim edhe për studiuesit shqiptarë, pasi historiografia në fakt është një ligjërime i lidhur thellësisht me politikën. Po ashtu edhe përpjekja e vetëdijshme për të përjashtuar dimensionin politik të historishkrimit është një qëndrim i caktuar politik. Po aq e vërtetë është edhe e kundërta: politika nuk është domen ekskluziv i politikanëve; puna e historianëve, përfaqësuesve të klerit dhe intelektualëve të kulturës ka, dashur pa dashur, dimensione dhe pasoja politike. Madje, mund të thuhet se janë ata që krijojnë dhe propogandojnë vlerat ‘nacionale’ me qëllim që të mbështesin aspiratat nacionale të një populli.

Shqiptarët, si myslimanë ashtu edhe të krishterë, e filluan lëvizjen për krijimin e shtetit të tyre të pavarur pa marrë “zyrtarisht” mbështetjen e asnjë Fuqie të Madhe. Ndaj dhe identiteti kombëtar shqiptar u mbrujt dhe u zhvillua paralelisht me rrezikun e zhdukjes së tyre nga skena e historisë. Në këtë kuadër, nacionalizmi në shkrimin dhe përdorimin e historisë, më shumë se një tendencë intelektuale e momentit, ishte reagim i historiografisë shqiptare ndaj kushteve politike të kohës, brenda dhe jashtë vendit.

Natyrshtëm që nacionalizmi ballkanik e rriti interesin e tij edhe në studimin e historisë së Ballkanit³. Edhe shqiptarët nuk bënë përjashtim në këtë drejtim. Historiografia shqiptare e gjysmës së dytë të shek. XIX më shumë se sa informon për atë se çfarë ka ndodhur në të shkuarën, e

² B. Güvenç, *Türk Kimliği – Kültür Tarihinin Kaynakları*, Kültür Bakanlığı Yayınları, Ankara 1993, f. 46.

³ G. Soulis, “Historical Studies ...”, f. 421.

idealizon atë, e ngjyros të dëshiruarën, jo ekzistuesen, duke imagjinuar të premtuarën që do ta shpëtojë. Shumica e atyre që u morën me shkrimin e historisë, qoftë edhe në funksion të politikës, nuk ishin historianë të përgatitur dhe kualifikuar mirëfilli si të tillë, por elementë patriotë, ndaj edhe veprat e tyre më tepër se “shkencore” karakterizoheshin nga një shpirt romantik dhe narrativ, me mungesa të forta normash kritike. Një gjë e tillë e bën shumë të vështirë që në kësi lloj shkrimesh historike të shquash se ku mbaron legjenda dhe ku fillon historia e mbështetur në fakte të provuara historike.

Historiografia shqiptare e gjysmës së dytë të shek. XIX nga nacionalistët shqiptarë u vlerësua si një mjet për nxitjen e ndjenjave nacionale dhe në këtë kontekst si mundësi për shpalosjen e pikëpamjeve të tyre politike. Kjo formë shkrimi që evokonte të kaluarën që nga kohërat e vjetra dhe ishte një mundësi për shpalosjen e ideve dhe qëndrimeve të tyre politike përcaktoi edhe karakterin enciklopedik të këtyre shkrimeve.

Autorët e parë shqiptarë që lëvruan historinë në funksion të zhvillimeve politike të momentit historik ishin Pashko Vasa⁴ dhe Sami Frashëri⁵. Me cilësinë e elementëve që ishin pjesë e elitës provinciale osmane, e krishterë dhe myslimane, këta dy personalitete të jetës politike dhe kulturore shqiptare, por po aq edhe të asaj osmane, ishin formuar dhe ndikuar fuqimisht nga veprat e kulturës franceze.

Në traktatin e tij ku përfshihet në një të tërë historia e viseve shqiptare nga antikiteti deri në momentet kur u shkrua kjo vepër, Pashko Vassa (alias Vassa Pasha) promovon idenë se shqiptarët në fund të viteve '70 të shek. XIX në vend të pavarësisë duhet të kërkonin autonomi, duke

⁴ Kjo vepër në vitin 1879 u botua njëkohësisht në frëngjisht në Stamboll: Wassa Effendi, *Etudes sur l'Albanie et les albanais*, Constantinople 1879; dhe në Francë: idem., *La vérité sur l'Albanie et les albanais. Etudes historique et critique*, Paris 1879; në anglisht: idem, *The Truth on Albania and the Albanians. Historical and Critical Issues*, London 1879; dhe në gjermanisht: idem, *Albanien und die Albanesen. Eine historisch-kritische studie*, Berlin 1879. Versioni shqip i përkthimit nga frëngjishtja i shoqëruar me komentim u botua prej Mehdi Frashërit: Vassa Efendi, *E vërteta mbi Shqipërinë dhe shqiptarët*, Shtypshkronja “Tirana”, Tiranë, 1935.

⁵ S. Frashëri, *Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhetë*, në: Vepra 2, Rilindja, Prishtinë 1978

e bërë kështu këtë vepër të shndërrohet në dokumentin kryesor ideologjik që shoqëroi Lidhjen Shqiptare të Prizrenit.

“Historia e Shqipërisë” e Dom Ndoc Nikajt e publikuar në vitin 1902⁶, duhet konsideruar si një urë lidhëse në mes shkrimit historik romantik të Rilindjes dhe atij patriotik që do të vijonte pas shpalljes së Pavarësisë. Ky libër shquhet për karakterin e tij nationalist, ndonëse autori është përpjekur të jetë i ekuilibruar në mendimet e tij. Në vepër nuk mbahet ndonjë qëndrim kritik ndaj shqiptarëve, megjithëse ka disa vlerësime të tërthorta për karakterin dhe organizimin e tyre. Gjithsesi, autori shprehet se “populli që nuk njeh historinë e vet është si një fmi që nuk njeh prindët e vet”⁷ dhe historinë ai e konsideron si një mjet për të treguar lashtësinë e një populli. Në këtë vepër Ndoc Nikaj bën përpjekje serioze për të argumentuar se shqiptarët janë banorët më të vjetër të Ballkanit, prirje kjo që është vërejtur edhe tek shkrimet enciklopedike të Pashko Vasës dhe Sami Frashërit, por më pas do të vërehet edhe tek Kristo Dako⁸ dhe Kostë Çekrezi.⁹

Duke iu referuar së shkuarës së lavdishme, historishkruesit shqiptarë morën përsipër detyrën e galvanizimit të misionit dhe ideve nacionale, madje duke i ofruar popullit modelin historik të një idenditeti tashmë të ngjizur kombëtar. Për rrjedhojë, historishkruesit e fillimshkullit XX duhen vlerësuar edhe si promovues të fuqishëm të nacionalizmit shqiptar. Gjithsesi, veprat historike të kësaj kohe mbeten ashtu siç shprehet B. Croce: “... monumente të rëndësishme të dashurisë për atdheun”¹⁰.

Pas nëntorit të vitit 1912 shqiptarët e të gjitha përkatësive fetare e kuptuan se tashmë duhet t’i dilnin vetë për zot atdheut të tyre. Shteti i brishtë shqiptar gjendej i rrethuar nga fqinjë me pretendime të qarta territoriale dhe përballej me një njohje të sforcuar ndërkombëtare. Në këto kushte ishte krejt e natyrshme që historiografia nacionaliste e viteve 1910-1920 të kishte një funksion të dyfishtë: t’i drejtohej si opinionit të

⁶ N. Nikaj, *Historia e Shqypnis*, Bruxelles 1902. Kjo vepër u ribotua nga shtypshkronja “Nikaj” në Shkodër, në vitin 1917.

⁷ Ibid., f. 1-2.

⁸ *Cilët janë sqipëtarët ?*, Manastir 1911.

⁹ *Historia e Shqipërisë*, Botime të Federatës Panshqiptare “Vatra”, Shtypshkronja ‘Dielli’, Boston 1921.

¹⁰ B. Croce, *Storia della storiografia italiana*, vol. I, Gius. Laterza & Figli, Bari 1930, f. 9.

brendshëm ashtu edhe atij të jashtëm. Me fjalë të tjera, historia duhej përdorur si armë shpirtërore/ideologjike në rrugën e organizimit të brendshëm të popullit shqiptar,¹¹ kurse nga ana tjetër, historia duhej shfrytëzuar për ta bërë të njohur ndërkombëtarisht Shqipërinë dhe shqiptarët me synimin për të kundërshtuar planet për copëtimin eventual të trojeve shqiptare të hartuara nga Fuqitë e Mëdha; madje edhe për të ndikuar politikisht mbi qarqet vendimarrëse ndërkombëtare.¹² Në shkrimet historike që u botuan në këtë segment kohor, pretendohet se i shërbehet me materiale njohëse kancelarive të Fuqive të Mëdha. Retorika e literaturës historike përmbushte një mision të caktuar politik, por që e gjykojnë nga pozita nacionaliste ishte një mision patriotik.

Historia vazhdonte të konsiderohej si një mjet që i shtonte madhësinë së kaluarës dhe fisnikëri legjitimitetit të një populli për të mbijetuar, ndërkohë që tematika e shkrimeve historike vazhdonte të ishte e fiksuar në rezistencën popullore kundër osmanëve dhe në ndriçimin e figurave kryesore udhëheqëse¹³. Me fjalë të tjera, shkrimet historike trumbetonin bashkimin e popullit shqiptar pa dallim feje dhe ideje dhe vazhdonin të kryenin një mision patriotik përsa i përket konsolidimit të shtetit të brishtë kombëtar. Në këto kushte historike nuk ishte aspak rastësi që i njëjti autor, Mit'hat Frashëri (Lumo Skëndo), shkroi histori si për opinionin e brendshëm¹⁴ ashtu edhe për opinionin e jashtëm¹⁵. Për rrjedhojë, karakteri patriotik i historiografisë shqiptare e kishte burimin tek konjunkturat politike të brendshme dhe të jashtme, dhe e tillë vazhdoi të ishte deri në fund të Luftës II Botërore¹⁶.

Lëvrimi i temave të tilla të orientuara drejt *sakrificës, heroikes dhe njohjes së vetvetes* nuk ishte rastësi. Mjafton t'i hedhim një sy tematikës historike të trajtuar gjatë këtyre viteve dhe do të shohim se edhe tani

¹¹ N. Nikaj, *Historia e Shqypnis*, Shkodër 1917; K. Çekrezi, *Historia e Shqipërisë*, Boston 1921.

¹² Ch. A. Dako, *Albania - the Master Key to the Near East*, E. L. Grimes Company, Boston - Mass., 1919.

¹³ F. S. Noli, *Historia e Skënderbeut - Gjergj Kastriotit, mbretit të Shqipërisë*, Boston 1921.

¹⁴ L. Skëndo, *Pritmi i Shqipërisë*, Sofia 1915.

¹⁵ Idem, *La population de l'Épire*, Sophia 1915; Idem, *Albanais et slaves*, Lausanne 1919.

¹⁶ V. S. Visoka, *Nëna Kosovë*, Tiranë 1943; H. Kokalari, *Kosova djepi i shqiptarizmit*, Tiranë 1943.

mbizotëron tema e Skënderbeut dhe Lidhja Shqiptare e Prizrenit. Në këtë kuadër duhet marrë në konsideratë edhe përkthimi që I. M. Qafëzezi i bëri veprës së Aravantinosit për Ali Pashë Tepelenën. Momenti historik dhe panteoni shqiptar i figurave historike kishte nevojë edhe për Ali Pashën¹⁷.

Pjesa dërrmuese e mendimtarëve pararojë të fundit të shek. XIX dhe fillimit të shek. XX, jo vetëm në viset ballkanike por edhe në qarqet intelektuale drejtuese osmane, nuk ishin formuar si historianë të mirëfilltë në kuptimin modern të tij; megjithatë, disa prej tyre ishin në të njëjtën kohë edhe ndër shkruarit më të lexuar të kohës. Veprat e tyre historike kishin ndikim të fuqishëm mbi masat popullore përsa i përket gjykimit të së shkuarës historike¹⁸.

Rezistenca 25 vjeçare antiosmane e udhëhequr nga Skënderbeu ka qenë burimi më i madh i frymëzimit sa herë që është vënë në diskutim mbijetesat historike e shqiptarëve. Kjo rezistencë, në kujtesën e popullit, nuk është ngulitur vetëm si një rezistencë kundër një armiku, por si një nga shembujt më të shkëlqyer të vetëorganizimit të shqiptarëve në momentin kur diskutohet mbijetesat e tyre. Nga ana tjetër, Skënderbeu me heroizmin që tregoi në luftë kundër osmanëve dhe me famën që fitoi, ndërkohë që Perëndimi ishte në ditë të vështira, u shndërrua në një burim krenarie për shqiptarët kudo që ata ndodheshin.

Me emrin e Fan Nolit lidhen një varg studimesh për figurën e Skënderbeut dhe epokën e tij¹⁹. Libri i parë, i shkruar në vitin 1921, ishte i natyrës populiste dhe më tepër dukej të ishte shkruar nga një shqiptar nacionalist se sa nga një studiues profesionist. Në këtë libër, të cilin mund ta vlerësojmë si një “guidë” të luftës monumentale shqiptare të përgatitur kundër rreziqeve politike që po kalonte Shqipëria në fund të Luftës I Botërore, Skënderbeu, më tepër se një personalitet real, na shfaqet si një

¹⁷ I. M. Qafëzezi, *Historië e Ali Pashë Tepelenës*, Edicjë e I-rë, Bukuresht 1916.

¹⁸ M. Ursinus, “From Süleyman Pasha to Mehmet Fuat Köprülü: Roman and Byzantine History in Late Ottoman Historiography”, *Byzantine and Modern Greek Studies*, 12 (1988), f. 307.

¹⁹ F. S. Noli, *Historia e Skënderbeut - mbretit të Shqipërisë (1412-1468)*, Shoqëria Korçare ‘Arsimi’, Shtypshkronja e ‘Diellit’, Boston Mass., 1921; Idem, *George Castrioti Scanderbeg, 1405-1468*, International Universities Press, New York 1947; Idem, *Historia e Skënderbeut - kryezotit të Arbërisë (1405-1468)*, Federata Pan-Shqiptare ‘Vatra’, Boston Mass., 1950.

figurë legjendare. Në ato ditë të vështira shqiptarët kishin shumë nevojë për një simbol të tillë.

Megjithatë, figura e Skënderbeut edhe gjatë periudhës komuniste mbeti një ndër më të preferuarat në historiografinë shqiptare, pasi ndriçimi i kësaj figure ishte i pranueshëm edhe për regjimin komunist. Tek figura e Skënderbeut dhe tek historia e shkruar për të, regjimi komunist pa idealin e legjitimitetit të ambicieve të veta autoritare. Një temë e tillë si e Skënderbeut, e përdorur gjerësisht nga historishkruesit shqiptarë para Luftës II Botërore, mbeti e tilla edhe gjatë periudhës komuniste, pasi Skënderbeu ishte modeli më i mirë i qëndresës dhe rezistencës, tashmë në kushtet e vetizolimit dhe shkëputjes si nga Lindja ashtu edhe Perëndimi. Ai fare mirë shërbente si një model i mirë emulacioni.

Sot mund të thuhet pa mëdyshje se Lidhja e Prizrenit, ngaqë është një nga ngjarjet më të rëndësishme të historisë kombëtare shqiptare, zuri një vend të rëndësishëm si në historiografinë nacionaliste të para Luftës II Botërore²⁰, ashtu edhe në historiografinë marksiste²¹, por edhe pas vitit 1990²². Qysh në historiografinë nacionalisto-patriotike fenomeni i Lidhjes

²⁰ K. A. Dako, *Liga e Prizrenit*, Bukuresht 1922; M. Frashëri, *Lidhja e Prizrenit dhe efektet diplomatike të saj*, Shtypur në shtypshkronjën “Mbrothësija”, Tiranë 1927; Xh. Belegu, *Lidhja e Prizrenit e veprimtaria e saj, 1879-1881*, Shtëpia Botonjese “Kristo Luarasi”, Tiranë, Qershuer 1939; M. Merlika, “Karakteret e natyrshme e historike të Shqypnis së Madhe”, *Hylli i Dritës*, XIX, nr. 6-8 (1941), f. 236-46.

²¹ *Konferenca Kombëtare e Studimeve për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit (1878-1881)*, 12-18 qershor 1978, vol. I-II, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë – Instituti i Historisë, Tiranë 1979; K. Frashëri, “Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe rëndësia e saj historike”, *Studime historike*, nr. 4 (1988), f. 125-36; Idem, *Lidhja e Prizrenit (1878-1881)*, vol. I, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë – Instituti i Historisë, Tiranë 1989; Idem, *Lidhja e Prizrenit (1878-1881)*, Botimet TOENA, Tiranë 1997; Stefanaq Pollo, “Lufta e popullit shqiptar për çlirimin kombëtar nën udhëheqjen e Lidhjes së Prizrenit”, *Studime historike*, nr. 2 (1968), f. 89-114; Shyqri Ballvora, “Lidhja e Prizrenit dhe çështja e autonomisë së Shqipërisë”, *Studime historike*, nr. 2 (1968), f. 115-32.

²² K. PRIFTI, “LA PUBLICATION ET LA DIFUSION EN EUROPE DE L’OEUVRE DE PASHKO VASA, ‘LA VÉRITÉ SUR L’ALBANIE ET LES ALBANAIS’”, *STUDIA ALBANICA*, XXXIV (2001), F. 37-44; IDEM, “MISSIONI I DY SHQIPTARËVE NË EVROPË (ABDYL FRASHËRIT DHE MEHMET ALI VRIONIT)”, *STUDIME HISTORIKE*, NR. 3-4 (2006), F. 131-148.

së Prizrenit filloi të studiohej në mënyrë shumëdimensionale²³ dhe në dritën e dokumentave autentike²⁴. Kjo temë sëbashku me Skënderbeun janë dy më të lëvruarat në literaturën historike shqiptare të para Luftës II Botërore, pasi “Lidhja e Prizrenit asht për Kombin Shqiptar guri i parë i themelit të rilindjes së ti kombëtare e për kte arsye na duhet me e dijtë si nisi e si mbaroi”²⁵. Madje, Lidhja e Prizrenit, që shënoi një nga momentet kulmore të nacionalizmit shqiptar, kur ishte temë e ditës, u bë edhe objekt i fjalimeve të zjarrta politike²⁶; madje ajo u vlerësua, pas epopesë së Skënderbeut, si “kurora e dytë e Glories shqiptare”²⁷.

Në shekullin XIX, që është shekulli i nacionalizmit ballkanik, si faktor i brendshëm i ringjalljes së idealeve kombëtare të popujve ballkanikë ishte copëtimi i Shtetit Osman, ndërsa si faktor i jashtëm mund të konsiderohen hesapet politike në mes Fuqive Ballkanike²⁸. Për intelektualët shqiptarë të para Luftës II botërore, Lidhja e Prizrenit ishte shprehje e ndërgjegjësimit kombëtar të një populli, që i përkiste feve të ndryshme²⁹.

K. A. Dako që në titull të punimit të tij shpalos qëndrimin e tij nationalist ndaj Lidhjes së Prizrenit: “Liga e Prizrenit, e para lëvizje kombtare për të mprojtur tërësinë toksore të atdheut dhe për të fituar independencën e Shqipërisë, shoqëruar me dokumenta zyrtare”³⁰.

Historiografia shqiptare dhe ajo e shteteve të tjera ballkanike u zhvilluan kryesisht si historiografi me doza të forta nacionaliste, por ato u shoqëruan edhe me një lënie të vetëdijshme jashtë interesit të historisë së shteteve dhe popujve fqinjë. Ndërsa nacionalizmi u bë një faktor primar unifikues dhe normativ në formimin e identitetit kolektiv të një populli, për pasojë edhe historia e shkruar nacionale ishte ‘e pastër’ dhe ‘originale’; braktisja e qëllimtë e studimit të historisë së fqinjëve më

²³ M. Frashëri, *Lidhja e Prizrenit dhe efektet diplomatike të saj*, Tiranë 1938, f. 9-11.

²⁴ Xh. Belegu, *Lidhja e Prizrenit e veprimtaria e saj, 1879-1881: shih pjesën hyrëse*.

²⁵ Ibid., f. I.

²⁶ M. Merlika, “Karakteret e natyrshme e historike të Shqypnis së Madhe”, f. 237-239.

²⁷ M. Frashëri, *Lidhja e Prizrenit*, Tiranë 1938, f. 3.

²⁸ Ibid., f. 7-18.

²⁹ M. Merlika, “Karakteret e natyrshme ...”, f. 238-239.

³⁰ Bukuresht 1922.

tepër se një neglizhencë preferenciale ishte një parakusht i diktuar nga situatat dhe zhvillimet ndërkombëtare të fundshekullit XIX dhe dekadave të para të shek. XX. Për pasojë, edhe historia e shkruar nacionale ishte e tillë që për nga vlerat nuk mund të krahasohej me asnjë tjetër³¹ dhe aq më tepër me ato të fqinjëve. E njëjta linjë u konservua edhe gjatë periudhës komuniste, kur për shembull në trajtimin që iu bë Shpalljes së Pavarësisë, studiuesi shqiptar politikisht ishte shumë i kujdesshëm për të mos përdorur asnjë shprehje që do të cënonte marrëdhëniet me fqinjët, teksa shprehej pa asnjë ekuivok:

“Lufta e popullit tonë për mbrojtjen e tërësisë territoriale të vendit dhe për bashkimin kombëtar nuk ka cënuar kurrë ndonjëherë të drejtat e popujve të tjerë të Ballkanit”³².

Stabiliteti relativ, i brendshëm dhe i jashtëm, që përfshiu Shqipërinë në fillim të viteve '20 dhe që vazhdoi deri në prag të Luftës II Botërore u reflektua edhe në fushën e studimeve historike, madje luajti një rol të rëndësishëm edhe në ndryshimin gradual të karakterit të tyre. Shkrimet historike, si edhe më parë, e ruajtën funksionin e mbartëses së misionit dhe transmetuesit të vlerave kombëtare. Historishkruesit shqiptarë të këtij segmenti kohor duke mos qenë historianë profesionistë, por personalitete të fuqishme politike njëkohësisht luajtën edhe rolin e konservuesve të miteve historike shqiptare. E thënë ndryshe, ata ishin edhe konstruktorë të forcimit të idenditetit nacional. Deri në fund të Luftës II Botërore ato vazhduan të përbënin masën kryesore të produktit të shkruar të historik jo vetëm në Shqipëri, por në të gjitha vendet ballkanike.

Në periudhën mes dy luftimeve botërore përgjegjësia e shkrimit të historisë kombëtare kishte rënë mbi shpatullat e aktorëve të politikës. Rruga më e mirë dhe më e shkurtër për ta realizuar legjitimitetin e shtetit të ri shqiptar ishte shkrimi i historisë nga protagonistët që e ndërtonin atë. Politikanët, burokratët dhe ekonomistët në Shqipëri ishin njëkohësisht edhe personalitetet që gëzonin formacionin bazë historik dhe ishin ata që plotësuan vakuumin e shkaktuar nga mungesa e historianëve profesionistë deri në momentin kur ky profesion do të institucionalizohej mirëfilli.

Këtë fenomen më së miri do ta ilustronte rasti i Mehdi Frashërit. Në librat e tij ai i mëshoi fort analizës së problemeve shqiptare, duke i

³¹ O. Özel, “Bir Tarih Okuma ve Yazma Pratiği olarak Türkiye’de Osmanlı Tarihçiliği”, *Sosyal Bilimleri Yeniden Düşünmek*, f. 149.

³² A. Puto, “Pavarësia e Shqipërisë në kuadrin e procesit çlirimtar në Ballkan”, *Studime Historike*, nr. 4 (1987), f. 36.

shpjeguar ato nëpërmjet analizës që i bën historisë, veçorive dhe pasurive që gëzojnë viset shqiptare³³. Studime të mirëfillta ai i kushtoi edhe momenteve të rëndësishme të historisë së shqiptarëve, si Lidhjes së Prizrenit³⁴, por në fokusin e interesave të tij intelektual-patriotike ishin edhe tema të tilla ekonomike, si për shembull perspektiva bujqësore e Shqipërisë³⁵. M. Frashëri tentoi të shkruajë edhe një histori Shqipërie të dimensioneve të mëdha, prej së cilës arriti të publikojë vetëm vëllimin e parë³⁶. Është me vend të vihet në dukje se Mehdi Frashëri është i vetmi historikshkruar shqiptar që termin *nacionalizëm shqiptar* e ka përdorur në titullin e një libërthi historik: *Nacionalizma shqiptare dhe faktorët ngatërrestarë të mbrendshëm dhe të jashtëm*, Tiranë 1943.

Edhe gjatë periudhës komuniste historianët shqiptarë morën përsipër detyrën për mbrojtjen dhe promovimin e “interesave nacionale”. Glorifikimi i figurave dhe personaliteteve historike të periudhës në prag të invazionit osman apo edhe kur sundimit osman po i vinte fundi u konsiderua si një mjet për t’u përballuar me efektet e asaj që shpesh është quajtur “nihilizim i vlerave nacionale”. Një qasje e tillë u pranua plotësisht nga udhëheqja komuniste, pasi “shkëlqimi” sidomos i personaliteteve mesjetare parakuptonte vazhdimësi në kohërat moderne të koncepteve të legjitimitetit të mënyrës autoritare, madje edhe ambicieve totalitare³⁷.

Vetëm se trajtimi historik i problemit të nacionalizmit në historiografinë komuniste, për nga objektivat që synonte të realizonte, nuk i ngjante fare atij të shek. XIX dhe atij të para Luftës II Botërore. Regjimi komunist i mbetur mes dy botëve për t’ia “shpjeguar” popullit situatën e vështirë ku kishte rënë, për të ngritur lart moralin dhe, pse jo, për t’i zgjatur jetën vetes, mori si shembull aktet heroike me karakter popullor që “fshiheshin” në histori. Në këtë mënyrë regjimi komunist

³³ M. Frashëri, *Problemet shqipëtare*, Botonjës Ismail Mal’osmani, Tiranë 1944; idem, *Nacionalizma shqiptare dhe faktorët ngatërrestarë të mbrendshëm dhe të jashtëm*, Tiranë 1943.

³⁴ Idem, *Liga e Prizrenit edhe efektet diplomatike të saj*, Shtypshkronja “Mbrothësija” – Kristo Luarasi, Tiranë 1927.

³⁵ R. Walsh, *Koka e Ali Pashë Tepelenës dhe rrethanat e vrasjes*, me një studim kritik të z. Mehdi Frashëri, Shtypshkronja “Tirana”, Tiranë 1934.

³⁶ M. Frashëri, *Histori e Shqipërisë dhe e shqiptarëve*, vol. I, Botim i Ministris s’Arsimit, Shtypshkronja “Vlora” Cav. G. Direttore e C., Vlorë 1928.

³⁷ M. Todorova, “Historiography of the Countries of Eastern Europe: Bulgaria”, *The American Historical Review*, vol. 97, no. 4 (october 1992), f. 1108.

shpresoi të konservonte mbështetjen e masave duke përfituar nga “ringjallja” e ndjenjave kombëtare.

Edhe popullsia shqiptare që jetonte në territoret e ish-Jugosllavisë iu nënshtrua teorisë marksiste-leniniste, si dhe ideologjisë së krijimit të një kombi të ri jugosllav, që kuptohet se nuk kishte asgjë të përbashkët me të kaluarën e shqiptarëve. Pas përpjekjeve në luftë kundër këtij asimilimi dhe mbështetur në rrethanat e krijuara, historianët kosovarë, u përpoqën që me anë të komunizmit apo organeve legale të forconin ndjenjën kombëtare³⁸.

Prej fillimit të viteve '90 tregun shqiptar të librit e kanë mbytur librat për historinë, çka në pamje të parë duket të jetë një zhvillim pozitiv. Sot çdokush ka të drejtë të botojë, madje edhe studime të karakterit historik. Në këtë treg “pjesën e luanit” e kanë zënë librat për historinë e Shqipërisë, të shkruara nga autorë shqiptarë dhe të huaj, të cilët deri në fillim të viteve '90 ishin të ndaluar të botoheshin në Shqipëri. Njoftime të shpeshta nga bota e librit bëjnë me dije se nuk janë të rralla rastet kur botohen edhe kujtime të personaliteteve të njohura, kryesisht të politikës. Interesi i madh për këto botime historike vjen nga që populli dëshiron të mësojë prej tyre të vërtetat e historisë dhe shpreson që aty të gjejë ato që nuk ka mundur t'i mësojë në tekstet e deritanishme zyrtare të historisë dhe nga po ata studiues që e kanë shkruar dhe po shkruajnë historinë edhe sot.

Pra fare lehtë mund të themi se në këto raste kemi të bëjmë me një lloj historie alternative krahas asaj zyrtare, paçka se ato mund të jenë të mbushura me doza të forta subjektivizmi dhe amatorizmi. Gjithsesi “nevoja” për të shkruar histori dhe “uria” për të lexuar histori kanë ardhur ngaqë edhe opinioni i gjerë është i vetëdijshëm se historia e shkruar sidomos gjatë pesëdhjetë vjetëve të shkuara është skematike dhe për pasojë është “fshehur” historia e vërtetë.

Megjithëse disa histori nacionale janë më pak ‘mitike’ se të tjerat, historitë nacionale të çliruara krejt nga mitet janë marrëzi të mendohen. Historianët definojnë “të drejtat historike”, argumentat për të cilat vërtiten rreth domosdoshmërisë imperative për të rikrijuar kufijtë dhe botën e diçkaje populiste që thirret “Golden Age”³⁹. Në këtë kontekst,

³⁸ I. Hoti, *Në udhëkryqet e historisë dhe të historiografisë shqiptare*, Instituti i Historisë, Prishtinë 2003, f. 276.

³⁹ M. Pearton, “Nicolae Iorga as Historian and Politician”, *Historians as Nation-Builders: Central and South-East Europe*, eds. D. Deletant & H. Hanak,

pyetja se çfarë është historia, për nga përdorimi dhe për nga kuptimi, kur shndërrohet në pyetjen se për kë porositet historia, atëherë ajo shndërrohet në një vegël problematike. Kjo është vija e demarkacionit, e cila po u kalua e bën historinë një shkencë “të rrezikshme”⁴⁰.

Por a mund të themi se shqiptarët, të paktën duke filluar që nga gjysma II e shek. XX, e kanë përmbushur misionin e tyre kombëtar duke hartuar një platformë të veprimit kombëtar ashtu siç fqinjët tanë veriorë dhe jugorë kanë bërë respektivisht me të famshmet *Naçertanie* dhe *Megali Idea*. Kapodistria, ministri i jashtëm rus në mes viteve 1816-1822, në një projekt që i paraqiti Car Nikollës I projektonte krijimin e pesë shteteve të krishtera në Ballkan, ku hapësirën e banuar nga popullsi bullgare ia kishte bashkangjitur Serbisë⁴¹. Udhëheqësi i luftës serbe për pavarësi nga Perandoria Osmane, Aleksandër Karagjorgjeviç, në vitin 1809, në kohën që i kërkoi mbrojtje Napoleonit, i bëri atij me dije projektin për krijimin e Jugosllavisë, dmth. për krijimin e një shteti të sllavëve të jugut në Ballkan⁴². Këto fakte dokumentare dëshmojnë pa asnjë dilemë se këto projekte kohësisht janë përgatitur disa dekada më parë se E. Garashanini të hartonte “Naçertanien” (1844). Jugosllavia, me cilësinë e një shteti federativ sllav, u njoh botërisht në vitin 1918 dhe vetëm pas një shekulli, në 2008, u shpërbë përfundimisht. Pra, projekti politik për Jugosllavinë zgjati jo pak, por dy shekuj.

Në ditët e sotme historia është laborator i shkencave humane⁴³. Ndaj ajo që një popull e bën me të vërtetë “popull” është marrëdhënia e ndërsjellë që ekziston në mes ndërgjegjes historike dhe procesit të mësimit të historisë kombëtare nëpër shkollat⁴⁴, ndërkohë që një shoqëri që nga shkollat e saj nuk nxjerr njerëz të mendimit dhe që realisht prodhojnë ide dhe hapin perspektiva, nuk mund të formëzohet dhe të bëhet komb⁴⁵.

MacMillan Press & School of Slavonic and East European Studies of London University, London 1988, f. 160.

⁴⁰ K. Jenkins, *Tarihi Yeniden Düşünmek*, Dost Kitapevi Yayınları, Ankara 1997, f. 38.

⁴¹ H. Inalcık, *Tanzimat ve Bulgar Meselesi*, TTK yayınları, Ankara 1994, f. 41.

⁴² Ibid.

⁴³ E. Kongar, *Tarihimizle Yüzleşmek*, Remzi Kitabevi, İstanbul 2006, f. 11.

⁴⁴ B. Güvenç, *Türk Kimliği ...*, f. 28-30.

⁴⁵ Ibid., f. 45-6.